



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:276065
Datë: 29.08.2023
Numri i dokumentit: 04627052
C.nr.1780/2021

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Blerim Beshtica, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B(B)K nga GJ., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson R.G., nga GJ., rr."24 M", nr. 227, kundër të paditurit N.H., nga fsh. K., komuna e GJ.t, me bazë juridike pengim i posedimit dhe shkatim i dëmit material, vlera e kontestit 1,500 euro, jashtë seancës me datën 29.08.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Ndërprehet procedura në këtë çështje kontestimore për shkak të vdekjes së paditësit B(B)K nga GJ..

II. Procedura e ndërprerë do të vazhdoj kur trashëgimtarët e paditësit e marrin përsipër procedurën, apo kur të njëjtit i thërret gjykata që ta bëjnë këtë, apo me propozimin e palës kundërshtare.

A r s y e t i m

Paditësi B(B)K përmes të autorizuarit të tij R.G. përmes të autorizuarit të tij, me datë 08.12.2021 ka parashtruar padi kundër të kundër të paditurit N.H., me bazë juridike pengim i posedimit dhe shkatim i dëmit material.

Paditësi, në këtë gjykatë në një lëndë tjetër e cila udhëhiqet sipas shenjës C.nr.1436/2021 është si palë e paditur, të cilin e perfaqëson av. H.J., nga GJ., kurse si paditës janë M.J., Z.J.D.J., T.J., të gjithë nga GJ., N.M., nga P. dhe O.P., nga F.K., të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. V.P.nga GJ., e për të cilën lëndë, gjykata pasi ka dërguar ftesat për palët, për të paditurin nga dorëzuesi i postes është shënuar në fletëdergesën për dorëzimin personal konstatimi se pala është i vdekur, për çka gjykata ka kërkuar nga Komuna e GJ.t- Zyra e Gjendjes Civile në GJ.për të verifikuar faktin e vdekjes së të njëjtit, në këtë rast për të paditurin B.K.sipas lëndes C.nr.1436/2021.

Nga Drejtoria e Administratës së Përgjithshme të Komunës së GJ.t, më datë 04.08.2023, kësaj gjykate i janë kthyer shënime zyrtare përmes të cilës është njoftuar se i padituri B.K.gjindet në sistemin e gjendjes civile si i vdekur, me ç'rast këtij njoftimi edhe ia ka bashkëngjitur edhe

Certifikatën e Vdekjes, me numër rendor 417, të lëshuar nga ZGJC GJ.me datë 16.08.2023, me të cilën konstatohet se i padituri ka vdekur me datë 14.09.2022.

Duke pas parasysh që gjykata ka nga rrethanat e sipërcekura ka kuptuar se paditësi ka vdekur dhe për të njejtin posedon edhe certifikatën e vdekjes ku konstatohet vdekja e tij, gjykata vendosi të ndërprejë procedurën në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që sipas nenit 277, paragrafi 1, pika a) të LPK-së është paraparë se në rastet kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësin procedurale dhe nuk ka me prokurë në gjykim, procesi gjyqësor ndërpritet, ndërsa me nenin 280.1 të po këtij ligji është paraparë se procedura që është ndërprerë për shkaqe të treguara në nenin 277, paragrafi 1, pika a) dhe d) të këtij ligji do të vazhdohet kur trashëgimtari, apo kujdestari i pasurisë trashëgimore, përfaqësuesi i ri ligjor, administratori i falimentimit apo pasardhësi juridik i personit juridik, e marrin përsipër procedurën apo kur i thërret gjykata ta bëjnë këtë, me propozimin e palës kundërshtare.

Prandaj, nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJ.
C.nr.1780/2021, më datë 29.08.2022

Gjyqtari,
Blerim BESHTICA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.